

VENDIM
Nr. 61, datë 3.2.2017

PËR MIRATIMIN E PAKETAVE TË PAJISJEVE MJEKËSORE TË RIMBURSUESHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr.10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paketa e pajisjeve mjekësore të rimbursueshme, si pjesë e paketave të shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, financohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Lista e pajisjeve mjekësore hartohet nga komisioni teknik i listës së pajisjeve mjekësore të rimbursueshme, i cili ngrihet me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit.
3. Komisioni përfshin në listën e pajisjeve të rimbursueshme, pajisje të cilat janë të regjistruara dhe plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi për pajisjet mjekësore.
4. Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda datës 30 shtator të çdo viti, i dërgon Ministrisë së Shëndetësisë, listën e pajisjeve mjekësore të importuara dhe të prodhuara gjatë vitit kalendarik, si dhe subjektet përkatëse importuese e prodhuese.
5. Ministri i Shëndetësisë, brenda datës 15 tetor të çdo viti, i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave çmimet e deklaruara nga subjektet importuese të regjistruara të pajisjeve mjekësore gjatë vitit kalendarik.
6. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, brenda 20 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës për informacion, dërgon pranë Ministrisë së Shëndetësisë çmimet e deklaruara nga importuesit dhe prodhuesit e regjistruar të pajisjeve mjekësore gjatë vitit kalendarik.
7. Ministria e Shëndetësisë i dërgon Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor informacionin për pajisjet mjekësore, importuesit dhe prodhuesit, si dhe çmimet e importit, të mbledhura nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore e Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti.
8. Lista e pajisjeve mjekësore, e përfunduar nga komisioni, i paraqitet për miratim Këshillit Administrativ të Fondit.
9. Marzhet e tregtimit me shumicë dhe pakicë në rrjetin e hapur farmaceutik, si dhe marzhet e tregtimit të rrjetit spitalor, përcaktohen çdo vit, bashkë me listën përkatëse vjetore.
10. Lista e pajisjeve mjekësore të rimbursuara, e miratuar nga Këshilli Administrativ i Fondit, i dërgohet Ministrisë së Shëndetësisë për të vijuar procesin e miratimit pranë Këshillit të Ministrave.
11. Për vitin 2017, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, do të dërgojnë informacionin e përcaktuar në këtë projektvendim në Ministrinë e Shëndetësisë, brenda datës 28 shkurt 2017.
12. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi